



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A.

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**LËNDA: PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Implementimi i shërbimit të fiskalizimit dhe mirembajtje vjetore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):72224100-2
Shërbimet e programimit për implementimin e sistemeve.

Fondi limit: 4.983.332 (kater milion e nentëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy) leke pa TVSH.

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Formularit përmbledhës të vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiar **2022, 2023 dhe 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20% të vlerës** së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes dhe të deklaruar ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e

mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatikë ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

- a) Të paktën 3 (tre) punonjës ku një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e Flare Billing ose ekuivalent, një të jetë i certifikuar në zhvillim në gjuhën PHP ose ekuivalent, dhe një të jetë i certifikuar në zhvillimin e zgjidhjes së fiskalizimit të ofruar.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Certified SOA Professional (profesionist i certifikuar për arkitekturë orientuar nga shërbimet) ose ekuivalent.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).
- f) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Profesionist në Sigurinë Ofensive (OSCP ose ekuivalente).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat e shkollës së lartë
2. Certifikatat/transkriptet që vërtetojnë certifikimet e mësipërme të kërkuara
3. Formularët E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së zhvillimit të procedurës

Shënim: Një punonjës mund të disponojë edhe më shumë se një certifikatë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “d”, “e”, “f”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktuese përcaktojnë kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë duke u bazuar në:

- a) Pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,
- b) Gjendjen ekonomike dhe financiare,
- c) Aftësinë teknike dhe profesionale."

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilin nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesipërme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar janë kryer në baze të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjithë informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të afroje trajnim për përdoruesit.

- a) Duke qenë se AK ka në përdorim aktualisht sistemin "Flare Billing" është e rëndësishme që OE të ketë punonjës të certifikuar në zhvillim në këto zgjidhje ose ekuivalente. Ky certifikim i garanton AK-se se OE ka specialiste kompetente për të garantuar një integritet të saktë me ndërfaqen e programit të Flare Billing për fiskalizimin e faturave, që zhvillimet që mund të kërkojnë gjatë periudhës së kontratës dhe gjithashtu mirëmbajtja e integritetit do të realizohen pa shkaktuar probleme në mbarëvajtjen e punës. Të gjitha detyrat e mësipërme janë specifikuar në paragrafin "**KËRKESAT TEKNIKE TË INTEGRIMIT**" pika 4 në specifikimet teknike. Gjuha e programimit të përdorur nga "Flare Billing" është PHP ndaj edhe OE duhet të paraqesë certifikime të stafit që provojnë këto kompetence. OE duhet të zotërojë gjithashtu certifikim të stafit në zgjidhjen e ofruar për të garantuar mbarëvajtjen e integritetit të dy anshëm midis "Flare Billing" dhe zgjidhjes së ofruar për fiskalizimin. Në këto mënyra jepet një garanci shtesë se OE do të mund të zhvillojë integritet sipas kërkesave të parashtruara.
- b) Punonjësi është i nevojshëm për të garantuar integritetin efektiv mes sistemeve "Flare Billing" dhe zgjidhjes së ofruar për fiskalizimin e faturave nëpërmjet web serviseve. Certifikatat përkatëse vërtetojnë që programuesi disponon aftësi të specializuara në zhvillimin e aplikacioneve me arkitekturë të orientuar drejt shërbimeve në rrjet (service-oriented) dhe sistemeve të shpërndara. Këto integritete realizohen përmes përdorimit të protokolleve të standardizuara si SOAP, REST ose protokolle të tjera ekuivalente, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të projektit.
- c) Punonjësi garanton Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik disponon staf me aftësi të avancuara profesionale, të nevojshme për realizimin e projektit në përputhje të plotë me kërkesat, afatet dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST). Punonjësi i certifikuar si Menaxher Projekti siguron organizimin efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike të operatorit ekonomik, duke mundur zbatimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të

menaxhimit të projekteve. Marrë parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit, roli i Menaxherit të Projektit është thelbësor në ndjekjen e gjithë ciklit të jetës së projektit.

- d) Punonjësi i kërkuar lidhet me rezultatet që duhet të permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë i dëshmon autoritetit kontraktor që operatori ekonomik (nepërmjet stafit të certifikuar si me sipër, garanton ideimin, konceptimin e shërbimeve IT të projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes që janë shumë të rëndësishme për AK dhe të vëna në dukje në DST dhe specifikime teknike.
- e) Një punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager), është i aftë për:

1. Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit: Gjatë implementimit të sistemi dhe realizimit të integritetit në objekt të kësaj kontrate, është e rëndësishme të keni një menaxher të certifikuar CISM ose ekuivalent që do të koordinojë dhe menaxhojë të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit, marrë parasysh që në sistem do të trajtohen të dhëna sensitive dhe personale të aplikantëve.

2. Planifikimin e Sigurisë: Përpara implementimit të platformës, është e rëndësishme të përgatitja një plan mbi sigurinë e informacionit. Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ofron njohuri rreth hartimit të politikave dhe strategjive të sigurisë, ndihmon në identifikimin e risqeve potenciale, dhe siguron që të gjitha aspektet e sigurisë janë të përfshira në planifikim.

3. Identifikimin e Rreziqeve dhe Menaxhimin: Përfshin njohuri rreth identifikimit dhe menaxhimit të risqeve të sigurisë së informacionit. Gjatë fazës së implementimit, mund të hasen sfida dhe risqe të ndryshme që kërkojnë një qasje të strukturuar për t'i adresuar.

4. Kontrollin e Proceseve: Në fushën e sigurisë së informacionit, është e rëndësishme të sigurohen që proceset janë të sigurta.

5. Ruajtjen e Integritetit dhe Konfidencialitetit: Gjatë implementimit të një sistemi informatik, është e rëndësishme të sigurohet integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit. Duke marrë parasysh që: platforma do të jetë e hapur për publikun; do të ngarkohen dokumenta me përmbajtje të dhënash personale, do të ndërveprojë me sisteme të tjera e-gov, ruajtja e integritetit dhe konfidencialitetit të dhënave elemente shumë të rëndësishme në këtë kontratë.

6. Ligjshmëria dhe Rregullatorët: Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ka njohuri rreth legjislacionit dhe rregullave të aplikueshme në fushën e sigurisë së informacionit. Është e rëndësishme të sigurohet që implementimi i sistemit është në përputhje me të gjitha rregullat dhe kërkesat ligjore.

Një punonjës i certifikuar CISM ose ekuivalent ka njohuri dhe përvojë në fushën e sigurisë së informacionit, ky person do të jetë në gjendje të udhëheqë dhe të sigurojë që

implementimi i sistemit të jetë i sigurt dhe i përputhshëm me standardet e sigurisë së informacionit. Kjo mund të jenë kritike për ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe për përmbushjen e qëllimeve të sigurisë.

Për sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e procedurës, është e nevojshme dhe e rëndësishme prania e një menaxheri të sigurisë së informacionit i cili të mund të hartojë dhe dizenojë një plan të mirëdetajuar të zhvillimit të të gjithë detyrave të kërkuara duke mbajtur në konsideratë menaxhimin e incidenteve nëse do të ketë dhe menaxhimin e riskut të informacionit.

Që një sistem të jetë i qëndrueshëm dhe i përputhshëm me standardet dhe rregulloret, është e rëndësishme një qasje e integruar që përfshin të koordinuar menaxhimin e sigurisë dhe auditimin e sistemit.

Njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes këtyre certifikimeve mund të ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve, parandalimin e problemeve dhe sigurimin që sistemi objekt kontrate të punojë në mënyrë efikase dhe të sigurtë.

Për rrjedhojë, kombinimi i CISM ose ekuivalente, mund të sigurojë një qasje të plotë për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe auditimin e sistemeve të informacionit.

- f) Përfshirja e profesionistit të certifikuar OSCP ose ekuivalent është thelbësore për të garantuar sigurinë, integritetin dhe vazhdimësinë e shërbimit. Një profesionist i certifikuar zotëron aftësi të avancuara praktike për të identifikuar dhe eliminuar dobësi në sisteme, duke vepruar në mënyrë proaktive për të parandaluar sulmet kibernetike. Kjo siguri praktike është veçanërisht e rëndësishme gjatë përditësimeve, integriteteve të reja apo ndryshimeve të konfigurimit që mund të krijojnë hapësira për cenueshmëri.

Përveç mbrojtjes teknike, prezenca e një eksperti të sigurisë ndihmon në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave ligjore, duke rritur besueshmërinë e ofertuesit për realizimin e shërbimeve të përfshira në këtë procedurë prokurimi. Një profesionist i tillë jo vetëm që reagon në mënyrë të shpejtë dhe efektive ndaj incidenteve, por gjithashtu kontribuon në ruajtjen e qëndrueshmërisë operacionale dhe uljen e kostove afatgjata që mund të vijnë nga shkeljet e sigurisë apo humbja e të dhënave. Kjo e kthen mirëmbajtjen e sistemeve nga një proces rutinor në një funksion strategjik me vlerë të shtuar.

Profesionistit të certifikuar OSCP ose ekuivalent do të realizojë testet black box dhe white box të cilat janë të domosdoshme për të identifikuar dobësitë në një aplikacion web. Testet black box simulojnë sulme nga përdorues të jashtëm pa akses në kodin burimor, ndërsa testet white box analizojnë sistemet dhe strukturën e brendshme për të zbuluar probleme të brendshme të sigurisë duke mundësuar përdorues sistemi me nivele të ndryshme aksesit. Përdorimi i të dyja metodave siguron një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të aplikacionit.

Profesionisti duhet të komunikojë me zhvilluesit në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar, duke përshkruar dobësitë, ndikimin e tyre dhe hapat për zgjidhje. Bashkëpunimi duhet të fokusohet në rritjen e sigurisë së sistemit dhe jo në fajësim, duke ndihmuar zhvilluesit me udhëzime praktike dhe teknike për të adresuar problemet në mënyrë efektive.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponoj Certifikatat për standardet e mëposhtëme, të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me objektin e prokurimit të kësaj procedure:

- Certifikatën ISO 9001:2015 standardi i menaxhimit të cilësisë (ose ekuivalente e perditësuar)
- Certifikatën 27001:2017 standardi i sigurisë së informacionit (ose ekuivalente)
- ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT) e cila duhet të perkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen. (ose ekuivalente)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 77 dhe 79 të LPP, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit:

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e licensave të produkteve software dhe kryerjen e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni të jete në gjuhën shqipe si dhe të ketë të gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresën web të prodhuesit apo Distributorit për konfirmim të dokumentave të paraqitura. Të jete e përcaktuar emri, nipi dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi të ketë edhe datën e lëshimit përpara datës së zhvillimit të tenderit.

***Argumentimi:** Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon garanci që operatori ekonomik i interesuar do të ofrojë shitjen dhe instalimin e licensave të komponentëve të moduleve të sistemit pa sjelle incidente që mund të sjellin problematika afatgjate në vijueshmërinë e punës së shoqërisë, garancinë e mirëmbajtjes së sistemit dhe integritetive me palë të treta siç është përmendur dhe në specifikimet teknike, krijimi i site DR dhe instalimi i licensave perkatese dhe shërbime të tjera të sistemit, brenda afateve, të garantuar dhe të sigurt sipas standardeve të rekomanduara nga AKSK dhe AKSHI duke pasur mbështetjen e Prodhuesit apo Distributorit të Produkteve Software objekt të kësaj kontrate. Gjithashtu autoriteti nepermjet këtij autorizimi garanton që të gjithë të dhenat historike janë të sigurta gjatë këtij procesi i cili është shumë kritik dhe garanton rikthimin e tyre në gjendje fillestare në rast të cdo anomalie gjatë dinamikes së kontratës.*

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të jete i certifikuar ose partner zyrtar i cloud ku do të ofrohet shërbimi. Të vërtetohet nëpërmjet një dokumenti zyrtar të lëshuar nga ofruesi i shërbimit Cloud, i verifikueshëm, ose nëpërmjet shfaqjes në website zyrtar të ofruesit të shërbimit Cloud i emrit dhe detajeve të O.E.

***Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme vjen se rrjedhojë në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Për Sigurinë Kibernetike", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", i ndryshuar.*

Institucioni Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës shpesh është përcaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Për këtë arsye, meqenëse kërkohej krijimi i një site DR në cloud kërkohej që operatori ekonomik të garantojë me anë të një dokumenti që është i certifikuar ose partner zyrtar i Cloud-it ku operon dhe mirëmbahet site DR për të garantuar AK për kapacitetin e provuar të OE lidhur me shfrytëzimin e Cloud-it.

Te qenit i certifikuar ose partner i kompanise qe ofron sherbimin Cloud rrit garancine per AK qe OE i ploteson standardet per te qene rishites ose perdorues i sherbimit Cloud te zgjedhur per qellime komerciale dhe jo vetem per perdorim vetjak. Certifikimi ose partneriteti i cili shfaqet ne website zyrtar te ofruesve te sherbimeve cloud ose qe leshohet ne dokument zyrtar per OE te caktuar, eshte per te rritur reputacionin dhe besimin e OE te certifikuar ose me statusin partner lidhur me cilesine e sherbimeve te tij duke perdorur Cloud ne fjale, tek klientet e interesuar per sherbimet Cloud ne fjale sic edhe ne si AK jemi ne kete rast.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet te dorezoje nje propozim teknik per implementimin, mirembajtjen dhe funksionimin e site Disaster Recovery dhe te permbushjes se te gjitha kerkesave teknike.

***Argumentimi:** Implementimi i site Disaster Recovery eshte i rendesishem per SHRUK Durres. Implementimi i tij duhet te jete i sakt dhe i sigurt qe ne rast te nevojës se kalimit ne funksion te ketij site, ai duhet te plotesoje te gjitha funksionet dhe nevojat qe ploteson sistemi ne site primar. Eshte e rendesishme qe OE te pershkruaje menyren e implementimit dhe te jape fakte per plotesimin e kerkesave teknike qe jane shenuar ne Specifikime Teknike duke vendosur fakte si dokumenta zyrtar te leshuar nga prodhuesit e zgjidhjeve dhe teknologjive*

2.4.5 Operatori Ekonomik duhet te dorezoje dokumenta zyrtare te leshuara nga organizata qe ofron sherbimin cloud ose link ne website zyrtar te sherbimit cloud te ofruar per site DR ku verteton qe cloud i perzgjedhur ploteson kerkesat per:

- Të jetë i besueshëm për përdorim në kontekste shtetërore dhe qeveritare,
- Me përputhshmëri të plotë me GDPR,
- I pajisur me certifikatat ISO/IEC 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit,
- I pajisur me ISO/IEC 27701 për menaxhimin e privatësisë së të dhënave.

***Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme vjen se rrjedhoje ne zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar.*

Institucioni Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sha eshte percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rendesishme e informacionit. Per kete arsye, meqenese kerkohet krijimi i nje site DR ne cloud kerkohet qe operatori ekonomik te garantoje qe sherbimi cloud i perzgjedhur per implementimn e site DR te plotesoje minimalisht kerkesat e mesiperme.

Kompania qe ofron sherbimin cloud duhet te jete i certifikuar per perdorim sherbimesh IT nga institucione publike dhe qeveritare. Sektori publik dhe qeveritar ka rendesi te vecante dhe kerkon impenjime te specializara nga ana e kompanise qe ofron cloud, per kete arsye kjo duhet te

shprehet ose ne website e tyre zyrtar ne nje link te caktuar ose ne nje dokument zyrtar te perditesuar te leshuar nga kompania qe ofron cloud.

Në zbatim të ligjit të ri 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i cili është një ligj tërësisht i përafruar me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Bashkimit Europian 2016/679 (GDPR) shërbimi cloud duhet të jete ne perputhshmeri te plote me GDPR. Sistemet e ruajne te dhena si te shoqerise por edhe te abonenteve te saj te cilat jane sensitive dhe duhet te trajtohen ne zbatim te ligjit të ri 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

ISO/IEC 27001:2017 është një standard i njohur ndërkombëtarisht për krijimin dhe certifikimin e një Sistemi Menaxhimi të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Marrja e këtij certifikimi do të thotë që shërbimi cloud ka zbatuar një program holistik sigurie në lidhje me aktivitetet e saj të kontrollit të sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të sistemit.

ISO/IEC 27701 specifikon kërkesat dhe ofron udhëzime për ngritjen, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një Sistemi të Menaxhimit të Informacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (PIMS). Ky standard ndërkombëtar merr në konsideratë GDPR-në dhe u lejon organizatave që e miratojnë atë të demonstrojnë qasjen e tyre ndaj mbrojtjes së të dhënave personale.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të jete i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. per ofrim zgjidhje software per fiskalizim.

Argumentimi: Sipas ligjit per fiskalizimin e faturave Nr 87/2019 ”Per faturen dhe monitorimin e sistemit te qarkullimit” kerkohet qe operatori ekonomik te jete i licensuar per zgjidhjen qe do te ofroje per fiskalizimin e faturave te shoqerise qe kerkohet ne kete procedure.

2.4.7 Deklaratë/Autorizim nga kompania prodhuese dhe/ose distributor i autorizuar i zgjidhjes "FLARE BILLING" që është zgjidhja në përdorim.

- Në rast të një Deklarate/Autorizimi nga një Distributor i Autorizuar, bashkangjitur duhet të jenë dhe dokumentacioni ku vërteton lidhjen midis Distributorit dhe Prodhuesit.

*** Deklarata/Autorizimi duhet të përmbajë email-in zyrtar të Prodhuesit, për verifikime të nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në 9nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim identifikimin e operatorëve ekonomik të cilët janë të autorizuar për marrjen/ përpunimin/ regjistrimin automatikisht të të dhënave nga sistemi akzistues i faturim-arketimit. Sic eshte

permendur ne specifikimet teknike ne paragrafin “**KËRKESAT TEKNIKE TE INTEGRIMIT**” **pika 4**, nga operatori ekonomik kërkohet qe te behen zhvillimet e duhura neqoftese Programi Faturimit (Flare Billing) up-date-tohet ne komponentët e tij apo up-grad-ohet ne funksionalitete apo teknologji, gjithashtu kërkohet qe te mirëmbahet përgjatë 12 muajeve te kontratës integrimi midis programit te Fiskalizimit dhe atij te Faturimit pasi këto dy programe do te transmetojnë te dhëna ne dy drejtime. Per arsyen e mësipërme Autorizimi i Prodhuesit do te garantoje ne menyre maksimale Autoritein Kontraktore qe si ne ndërhyrje ashtu dhe ne mirëmbajtje OE do te kete mbështetjen e prodhuesit te këtij Programi. Gjithashtu ky autorizim garanton qe ne rast te nje incidenti madhor, me ane te mbështetjes te prodhuesit OE mund te kthente gjithçka ne gjendjen e mëparshme.

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

***Shënim:** Kërkesat për certifikatat e mësipërme duhet të verifikohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).

***Shënim:** Personeli i lartpërmendur duhet të ketë një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muajve të fundit, e dëshmuar nga forma E-sig e listës së pagesave.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar, synohet që të garantohej gjithmonë shërbimi kur ofrohet dhe të parandalohen rastet e pamundura të prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (pushime vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj.).

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomikë do të konsiderohen të përmbushura me dorëzimin/prezantimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Aneksit 9 të DST. Në rastet kur Operator Ekonomik do të shpallet fitues, ai duhet të dorëzojë dokumentacionin e provës sipas kriterëve të tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumenteve të rreme dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I OBJEKTIT

Autoriteti kontraktor, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” dhe legjislacioni përkatës në fuqi, synon të përfitojë një zgjidhje teknologjike që të mundësojë shërbimin e **fiskalizimit në masë të faturave të abonentëve përmes integritit të plotë me sistemin ekzistues të faturimit**, si dhe **krijimin dhe fiskalizimin e faturave për shërbime të ofruara në sportele, në kohë reale**. Ky shërbim ka për qëllim të sigurojë automatizim, saktësi, pajtueshmëri ligjore dhe transparencë të plotë të të gjitha faturimeve të realizuara nga ndërmarrja.

2. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi kryesor i kësaj prokurimi është:

- **Sigurimi i shërbimit të fiskalizimit të faturave**, nëpërmjet një sistemi që të jetë i integruar plotësisht me sistemin ekzistues të faturimit që shoqëria përdor aktualisht (Flare Billing), me funksionalitete që sigurojnë marrjen automatike të të dhënave të klientëve, artikujve dhe faturave për t’u fiskalizuar.
- **Fiskalizimi i faturave për shërbimet në sportele**, për krijimin dhe fiskalizimin në kohë reale të faturave për shërbime të ndryshme, të cilat nuk krijohen përmes ciklit standard të faturimit (si: vendosje ujëmatës, lidhje të reja, ndryshim emri, etj.).

3. KËRKESAT FUNKSIONALE

Sistemi i fiskalizimit duhet të integrohet plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme me sistemin ekzistues të faturimit të autoritetit kontraktor, duke përdorur shërbime Web mbi protokolle standarde komunikimi si SOAP ose REST, në mënyrë që shkëmbimi i të dhënave për krijimin, verifikimin dhe konfirmimin e faturave të ndodhë në kohë reale pa degraduar performancën e sistemit bazë të Faturim–Arkëtimit; ky integrim duhet të sigurojë që të gjitha veprimet e brendshme të nevojshme për përgatitjen e faturave brenda sistemit të faturimit të përfundojnë me sukses dhe të shoqërohen me operacionet përkatëse të fiskalizimit.

Zgjidhja duhet të marrë automatikisht të gjithë informacionin e nevojshëm nga sistemi i faturimit për çdo abonent dhe për çdo faturë, përfshirë identifikuesit e abonentit dhe kontratës, numrin e kontratës, NIPT për abonentë të kategorisë privat apo institucion shtetëror, artikujt e detajuar të faturës si ujë i pijshëm, ujë i përdorur, tarifë shërbimi, kështu ujëmatësi, si dhe taksat vendore, afatin e pagesës; pas marrjes së të dhënave, sistemi duhet të realizojë fiskalizimin e faturave në masë brenda një afati jo më të gjatë se njëzet e katër orë nga momenti i konfirmimit të ciklit nga sektori përkatës i shitjeve, duke mundur që faturat e gjeneruara në programin e faturimit të kalojnë automatikisht në modulen fiskalizimit pa ndërhyrje manuale. Shoqëria ne te gjithë njësitë e saj ka në total rreth 140 mijë abonentë të cilët faturohen çdo muaj.

Zgjidhja duhet të garantojë që përmes integritit të dyanshëm të rikthehet në sistemin e faturimit çdo informacion i prodhuar gjatë fiskalizimit, identifikuesit e faturave tatimore dhe metadatat përkatëse, në mënyrë që raportimi operacional të jetë i unifikuar duke ruajtur uniformitetin proceduror, gjurmueshmërinë dhe pajtimin e vazhdueshëm me kornizën ligjore.

Në funksion të plotësimit të skenarëve të korigjimit të faturimit, integrimi dhe zgjidhja e ofruar duhet të ofroje mundësinë e krijimit të faturës korigjuese automatikisht, në klikim nga përdoruesi. Pra integrimi duhet të realizohet edhe me funksionalitetin e faturës së zbritjes në sistemin e faturimit.

Zgjidhja duhet të ofrojë informacion mbi statusin e fiskalizimit, duke dalluar qartë faturat e fiskalizuara nga ato në pritje ose të refuzuara.

Për të mbështetur kërkesën operacionale për përpunim në masë të faturave, sistemi duhet të jetë i aftë të fiskalizojë volumet mujore të faturimit pa kufizime artificiale as në numrin e faturave e as në numrin e përdoruesve aktivë njëkohësisht, dhe pa kompromentuar kohën e përgjigjes apo integritetin e të dhënave.

Zgjidhja duhet të gjenerojë automatikisht Librin e Shitjeve, të dërgojë të dhënat në administratën tatimore përmes certifikatës elektronike dhe kanalit të sigurt të komunikimit, të marrë dhe të ruajë mesazhin konfirmues të administratës tatimore pas verifikimit të çdo fature individuale, të prodhojë dhe të asociojë me çdo faturë numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës dhe, sipas rastit, numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese, si dhe të gjenerojë kodin QR me mundësi printimi të menjëhershme të faturës.

Zgjidhja e ofruar duhet të ofrojë mundësinë e sinkronizimit të të dhënave të ruajtuara në sistemin e fiskalizimit, të dërguara me sisteme të tjera si Selfcare (për Operatoret, Vend ushtrimet, arkat) apo zgjidhje të tjera të përdorura me pare. Në këtë mënyrë garantohet shkarkimi i të dhënave reale e të plota të veprimtarisë së shoqërisë deri në momentin e kërkuar nga përdoruesi.

Zgjidhja e ofruar duhet të mundësojë shkarkimin e faturës elektronike në format PDF sipas formatit të DPT-se.

Zgjidhja e ofruar duhet të mundësojë shkarkimin e të dhënave të plota rreth artikujve të shitur në një periudhë të caktuar.

Operatori Ekonomik duhet të mundësojë ambjent për vazhdimësinë e punës (Ambjent Disaster Recovery). Ky ambjent duhet të integrohet me sistemin e Flare Billing për një kalim automatik të ngarkesës së punës në ambjentin DR në rast problematike të ambjentit primar.

4. KËRKESAT TEKNIKE TE INTEGRIMIT.

Sistemi i ofruar duhet të integrohet me sistemin e faturimit aktualisht në përdorim Flare Billing. Ndërfaqja për fiskalizimin e faturave të periudhës së faturimit, duhet të jete e integruar me hapat për mbylljen e periudhës së faturimit në sistemin Flare Billing. Në rast se nuk janë fiskalizuar të gjitha faturat nga periudha e mëparshme nuk duhet të lejohet çelja e një periudhe të re faturimi në sistemin Flare Billing. Ndërfaqja për fiskalizimin e faturave, duhet të mundësojë evidentimin e faturave të cilat nuk janë fiskalizuar me sukses për arsye të të dhënave jo të sakta për NIPT e subjektit privat apo për NID të abonentëve familjare dhe të mundësojë postimin e tyre si fatura me “blerës rastësorë”. Postimi i të dhënave në shërbimin e fiskalizimit duhet të realizohet nëpërmjet ekzekutimit në paralel duke ofruar një performancë të lartë për të realizuar fiskalizimin e faturave në kohe. Fushat e kthyerat në përgjigje të shërbimit të fiskalizimit duhet të ruhen edhe në databazën e sistemit Flare Billing. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në sinkronizimin e përgjigjeve

ne mënyre te tille qe përditësimi ne databazen e sistemit Flare Billing te jete i sakte dhe te mos ketë ngatërresa.

Ndërfaqja e fiskalizimit duhet te mundësoje përditësimin e progresit ne mënyre vizuale dhe te ofroje eksportim ne format Excel. Ne rast te realizimit te faturave te zbritjes, duhet te mundësohet modifikimi i funksionalitetit aktual, duke shfrytëzuar arkitekturën e zgjidhjes aktuale për te shtuar menaxhimin e një ndodhie specifike (Realizimi i Fatures se Kthimit), duke postuar ne ketë rast te dhënat për faturën veprimin e korrigjimit. Ne ketë rast është i nevojshme shtimi i një ndërfaqe ku te pasqyrohet historiku i lidhjes se faturave ne Flare Billing me faturat ne sistemin e ofruar duke evidentuar link ne ketë sistem dhe elementet NSLF, NIVF te faturës. Ne klikim te link, duhet te hapet ne sistemin e ofruar fatura e fiskalizuar e lidhur me faturën ne sistemin e faturimit. Ne ketë mënyre ruhet një gjurmim i sakte dhe lehtësohet leximi i historikut te veprimeve nga përdoruesit e sistemit.

Integrimi duhet te mundësoje kryerjen e veprimeve nga përdoruesit, me ane te ndërfaqeve te lehta për tu përdorur pa nevojën e ndërhyrjes se personave teknike dhe gjithashtu procesi duhet te mund te nise atje ku është ndërprere ne rast te problematikave te pa pritura si psh ndërprerja e shërbimit te internetit. Ne çdo rast operatori ekonomik duhet te garantoje se nuk mund te duplikohen te njëjtat fatura me shume se një here as ne sistemin e ofruar dhe as ne DPT.

Është tepër e rëndësishme qe integrimi i kërkuar te mos ndikojë ne mirëfunksionimin e sistemit aktual, nisur nga rëndësia e tij për mbarëvajtjen e punës se përditshme dhe gjithashtu te mos ndikojë ky integrim ne performancen e sistemit. Operatori ekonomik duhet te ketë njohuri teknike te plota dhe te realizojë integrimin dhe ta mirembaje ate duke garantuar se zhvillimet e duhura neqoftese ne sistemin e faturimit behen up-date-te te komponentëve apo up-grade te teknologjisë apo funksionaliteteve te vete sistemit Flare Billing. Mirembajtja e integritetit eshte nje pike kyce e kësaj kontrate pasi sic eshte përmendur dhe me sipër transferimi i te dhënave do te jete ne dy anët dhe këto te dhëna ne fund duhet te rakordojnë midis dy sistemeve.

5. KËRKESAT TEKNIKE TË SIGURISË

Sistemi duhet të projektohet, të vendoset dhe të operohet në përputhje të plotë me kornizën ligjore të fiskalizimit dhe sigurisë kibernetike, duke garantuar që të gjithë hapat e krijimit, transmetimit, verifikimit dhe ruajtjes së faturave të kryhen në mënyrë të sigurt, të gjurmueshme dhe në kohë reale, ashtu siç parashikojnë rregullat për dërgimin e të dhënave me certifikatë elektronike, marrjen e konfirmimit nga administrata tatimore, gjenerimin e NSLF dhe të kodit QR, si dhe ruajtjen e të dhënave të faturave dhe të faturave shoqëruese;

Duke pasur parasysh se Autoriteti Kontraktor, si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit sipas Ligjit Nr. 2/2017 dhe VKM Nr. 553, datë 15.07.2020, ka detyrimin për të siguruar auditim dhe përditësim të vazhdueshëm të masave të sigurisë kibernetike, zgjidhja dhe infrastruktura mbështetëse duhet të jenë objekt i kontrollit periodik, të dokumentuar dhe të verifikueshëm, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë operacionale dhe të mbrojtjes së të dhënave në të gjithë ciklin e jetës së shërbimit.

Në përputhje me standardet e sigurisë dhe ligjin për sigurinë kibernetike, baza e të dhënave duhet të jetë e paaksesueshme jashtë sistemit dhe hyrja të sigurohet nëpërmjet kredencialeve individuale të tipit përdorues

dhe fjalëkalim dhe nëpërmjet kodit të një përdorimesh (One Time Password) i cili duhet të dërgohet me email ose nëpërmjet një aplikacioni mobile, me një mekanizëm të detajuar dhe të konfigurueshëm të roleve dhe autorizimeve që kufizon qasjen vetëm në ambientet, modulet dhe raportet e miratuara nga administratori; çdo krijim, ndryshim apo anulim i faturës duhet të gjurmohet me datë, orë, përdorues, të ruhet historiku i versioneve përpara dhe pas modifikimeve.

Për te garantuar vazhdimësinë e shërbimit, të dhënat duhet të kopjohen çdo ditë në mënyrë automatike në një vendodhje fizike tjetër dhe të verifikohet vlefshmëria sipas praktikave të miratuara të backup-it.

Duke qenë se sistemi do të operojë në mjedis cloud dhe në integrim me sistemin ekzistues të faturimit, komunikimi ndërmjet moduleve duhet të realizohet në kanale të shifruara dhe me konfigurime sigurie që parandalojnë cenime të konfidencialitetit dhe integritetit; infrastrukturën e cloud-it duhet të përmbushin kriteret për akses të sigurt, segmentim të mjediseve të instalimit, siguri të bazës së të dhënave dhe politika të rikuperimit, ndërsa kapacitetet dhe parametrat e shërbimit duhet të dimensionohen për ngarkesa e përcaktuara të punës dhe për pezullime minimale gjatë orareve operacionale. Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar ose partner zyrtar i cloud ku do të ofrohet shërbimi. Ky operator duhet të ofrojë datacenter në dy vende të ndryshme brenda BE ose në Shqipëri. Të dhënat e sistemit të fiskalizimit duhet të ruhen patjetër në një vend të BE ose brenda territorit shqiptar; gjithashtu edhe backup sipas kërkesës duhet të ruhet në një server në një vend të BE-se ose në Shqipëri.

Platforma duhet të mbështetet në teknologji të përditësuara dhe të suportuara nga prodhuesit në afatgjatë (Long Term Support), duke përfshirë përditësimet e gjuhës së programimit, të sistemit të bazës së të dhënave dhe të sistemit të operimit me konfigurime të përshtatura për performancë dhe siguri, përfshirë kontrollin e politikave të fjalëkalimeve dhe të skemave të shifrimit, rishikimin e skemave të bazës së të dhënave për të shfrytëzuar kapacitetet e versioneve të reja, si dhe konfigurimin e të drejtave të përdoruesve në nivel databaze; kërkohet që baza e të dhënave të mos jetë e aksesueshme jashtë sistemit, hyrja të sigurohet përmes kredencialeve individuale.

Zgjidhja e ofruar duhet të jetë e instaluar në një infrastrukturë cloud të mbrojtur nga një sistem “Web Application Firewall” i testuar dhe funksional. WAF duhet të mundësojë evidentimin e IP-ve origjinuese të kërkesave jo legjitime. Duhet të mundësohet komunikim i drejtpërdrejtë me firewall duke bllokuar vijueshmërinë e kërkesave nga IP-te origjinuese të kërkesave jo legjitime, duke bërë kështu mbrojtjen e server dhe kufizimin e përdorimit të burimeve vetëm në shërbim të përdoruesve.

Zgjidhja e ofruar dhe tërësia e përbërësve të infrastrukturës duhet të jetë e monitoruar duke ofruar mundësinë marrjes së masave paraprake në rast të përdorimit në kufij të kapacitetit të hapësirës fizike apo ndonjë prej burimeve të tjera të server.

Te gjithë skedarët e gjurmimit të veprimtarisë në infrastrukturë duhet të mbliidhen në një hapësirë qendrore dhe të jenë të aksesueshëm në rast të kërkesë nga Autoriteti Kontraktor.

6. NIVELI I SHËRBIMIT

Operatori ekonomik mban përgjegjësinë e plotë për integrimin e dyanshem të sistemeve, përfshirë kalimin automatik të faturave nga programi i faturimit në sistemin e fiskalizimit, regjistrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit shoqërues dhe arkëtimeve, kthimin e të gjitha konfirmimeve dhe metatave të fiskalizimit në programin e faturimit dhe sigurimin që fiskalizimi i cikleve periodike të ndodhë brenda

ditares maksimale kohore të përcaktuar prej 24 ore, pa kufizime artificiale mbi sasinë mujore të faturave apo numrin e përdoruesve njëkohësisht aktivë; ky detyrim përfshin edhe mbështetjen e plotë të sporteleve dhe arkave të shpërndara gjeografikisht, me vënie në funksion në të gjitha njësitë administrative të shoqërisë rajonale të përcaktuara nga autoriteti dhe me parashikimin e zgjerimit në raport me rritjen e bazës së abonentëve. Sistemi nuk duhet të ketë kufizime mbi numrin e njërive të ushtrimit të veprimtarisë, arkave apo përdoruesve të krijuar.

Përgatitja për përdorim e zgjidhjes së ofruar duhet të shoqërohet me testime funksionale dhe të performancës nën ngarkesë që simulojnë fiskalizimin në masë dhe krijimin e faturave në sportele, me verifikim të plotë të gjurmueshmërisë, auditimit dhe log-eve gjatë transmetimit drejt administratës tatimore, me kalim të qartë nga mjedisi i provës në prodhim (LIVE) pa ndërprerje të shitjeve dhe me njoftim zyrtar për çdo ndryshim që ndikon shërbimin.

Gjatë gjithë procesit operatori ekonomik detyrohet të trajtojë përdoruesit përfundimtarë dhe administratorët, të dorëzojë manualët zyrtarë të përdorimit dhe të mirëmbajtjes si dhe të ofrojë asistencë në menaxhimin e certifikatës elektronike të fiskalizimit dhe zëvendësimit të saj kur është e nevojshme.

Gjithashtu Operatori Ekonomik ka detyrimin të bëjë ndryshimet e nevojshme sipas vendimeve të ardhura nga DPT apo ndryshimi i legjislacionit të fushës.

Pas vënies në punë, mirëmbajtja ofrohet për një periudhë **njëzet e katër mujore** duke përfshirë monitorim proaktiv të funksionimit dhe të sigurisë, përditësime të arsyetueshme të programit dhe bazës së të dhënave, zgjidhje të defekteve dhe dorëzim të një raporti mujor mirëmbajtjeje që përmbledh veprimtaritë teknike, gjetjet e sigurisë, incidentet dhe masat parandaluese; në të njëjtën periudhë mbahen të zbatueshme të gjitha detyrimet e cloud-it për sigurimin e të dhënave dhe back-up, duke garantuar funksionimin sipas parametrave të dakordësuar të shërbimit.

Mbështetja operacionale duhet të udhëhiqet nga një skemë e kategorizimit të incidenteve dhe shkallëzimit me kohe-përgjigje dhe kohe-zgjidhje të përcaktuara për kategori kritike, të mesme dhe të ulëta, ku përgjigjja fillestare jepet brenda tridhjetë minutash dhe zgjidhja, sipas klasifikimit, varion nga njëzet e katër orë deri në dy ditë pune, me kufi maksimal dhjetë ditë kalendarike për rastet jo-kritike; ofrimi i këtij suporti kryhet në orarin zyrtar të punës të përcaktuar nga autoriteti, duke përjashtuar ditët e festave zyrtare, dhe shoqërohet me regjistrim të plotë të komunikimeve dhe veprimeve në sistemin e menaxhimit të incidenteve.

Operatori Ekonomik duhet të mundësojë akses AK pa kosto shtesë në një sistem të centralizuar për menaxhimin e ceshtjeve të mbështetjes teknike dhe raportimin e incidenteve duke e konsideruar këtë sistem thelbësor për transparencë, gjurmueshmëri dhe zgjidhje në kohë të çështjeve të raportuara. Sistemi duhet të mundësojë identifikues unik të ceshtjeve, menaxhim të ciklit të jetës, kategorizim të ceshtjeve për ndjekjen e SLA-se.

- Te mundësohet regjistrim unik i ceshtjeve, statuset e kërkesave, raportues/përgjegjës, afate dhe histori të plotë për çdo ceshtje.
- Monitorim i SLA dhe mundësi për pershkallesim: matje automatike të kohëve, njoftime proaktive, rregulla pershkallesimi dhe njoftime për tejkalim afatesh.
- Raporte periodike për KPI, kategorizim i problematikave të raportuara.
- Krijim automatik i ceshtjeve automatikisht nga email, mundësi për komentim dhe shtim të materialeve ndihmese në ceshtje.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)

Kategoria B (I Mesem)

Kategoria C (I Ulet)

Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i programit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë të punës së tyre</u>	Mos funksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<u>Nuk ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje	○ 30 min.për të kthyer përgjigje
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

cNë vijim të këtyre detyrimeve, operatori ekonomik është i detyruar të përmbushë kushtet e kontratës për kohëzgjatjen e një vjeçare të shërbimit, të garantojë që shërbimi i fiskalizimit të faturave të shitjes të jetë operativ gjatë gjithë periudhës së përcaktuar. Fillimi i shërbimit për shkak të proceseve kritike që përfshijnë do të jetë data e lidhjes së kontratës.